

# Të jetosh me ekrane



Fëmijët, ekranet, prindërit:  
si të jetojnë së bashku?

**Udhëzues** për prindërit

Këshilla për të shoqëruar fëmijët  
tuaj në përdorimin e ekraneve

ALBANAIS

action  
innocence





Prej disa viteve, ekranet dhe mjetet dixhitale janë bërë pjesë përbërëse e jetës sonë të përditshme. Si prindër, ne i përdorim çdo ditë për të komunikuar, punuar ose zbavitur.

Fëmijët tanë janë gjithashtu të ekspozuar, nëpërmjet përdorimeve tona, pastaj gradualisht krijojnë përvojat e tyre. Në varësi të moshës, ata /ato fillojnë të luajnë video lojëra, të shfletojnë internetin dhe të përdorin rrjetet sociale.

Mes gjithë këtyre ekraneve, si mund t'i ndihmojmë fëmijët të kenë një përdorim të shëndetshëm dhe të përgjegjshëm? Çfarë zgjidhjesh mund të gjejmë për të ruajtur një ekuilibër në gjirin e familjes?

Action Innocence ju propozon disa këshilla për të shoqëruar fëmijët tuaj në këtë udhë.


## Prezantimi i Fondacionit

Action innocence është një Fondacion i krijuar në vitin 1999 në Gjenevë, qëllimi i të cilit është promovimi i përdorimit të shëndetshëm dhe të moderuar të ekraneve. Ai ndërvepron në shkolla, zhvillon materiale parandaluese dhe programe trajnimi për profesionistët e arsimit e shëndetësisë dhe drejton fushata të mëdha ndërgjegjësimi.

# Përmbledhje

- 4**      **Për një përdorim të shëndetshëm të ekraneve te më të vegjlit (0-6 vjeç)**
- 
- 6**      **Fëmija im luan video lojëra**
- 
- 12**     **Fëmija im përdor internetin dhe rrjetet sociale**
- 
- 16**     **Ekspozimi ndaj përmbajtjeve të dhunshme ose pornografike**
- 
- 20**     **Ngacmimi dhe kërcënimi kibernetik mes nxënësve**
- 
- 26**     **Takimet e këqija në linjë (*grooming*)**
-

**Për një përdorim  
të shëndetshëm  
të ekraneve  
te më të vegjlit  
(0-6 vjeç)**




- Nëse fëmija im është nën 3 vjeç, nuk e lë atë të kalojë kohë para ekraneve.
- Unë favorizoj lojën e lirë, aktivitetin fizik dhe ndërveprimet me ata që e rrethojnë.
- Unë vendos rregulla për përdorimin e ekraneve që në moshë shumë të vogël.
- Unë respektoj treguesin e moshave në programe, lojëra dhe aplikacione.
- Unë zgjedh përmbajtjen që shfaqet bazuar në moshën e përdorues-it(es) më të ri/re.
- Unë i jap përparësi përmbajtjes me karakter ndërveprues.
- Unë jam i(e) pranishëm(me) dhe diskutoj me fëmijën tim lidhur me materialin që ai/ajo po shikon.
- Unë e inkurajoj të flasë për atë që ndjen.
- Unë nuk e ekspozoj fëmijën tim para ekranit gjatë vakteve të ngrënies e para se të flejë.
- Përdor sa më pak ekrane në praninë e tij/saj.

## **Ekranet nuk duhet ta pengojnë fëmijën tim:**

- Për të zbuluar hapësirën
- Për t'u ushtruar fizikisht
- Për të përdorur 5 shqisat e tij
- Për të ndërvepruar me ata që e rrethojnë
- Për të zhvilluar të folurit e tij
- Për të luajtur me fëmijët e tjerë
- Për të qenë krijues(e)
- Për të ëndërruar



# Fëmija im luan video lojëra





## E di që video lojërat i japin atij/asaj mundësinë:

- Të kënaqet dhe të argëtohet
- Të zhvillojë aftësi të reja
- Të përparojë dhe të fitojë
- Të jetë i(e) vlerësuar
- Të luajë me shokët dhe shoqet e klasës
- Të flasë me ta/to

## Unë interesohem për përmbajtjen:

- Kërkoj informacione në internet dhe pranë prindërve të tjerë para se të blej një lojë.
- Mësoj për përmbajtjen dhe moshën e këshilluar duke konsultuar [www.pegi.info](http://www.pegi.info).
- Informohem për kohëzgjatjen e lojërave.
- E di që në disa lojëra ofrohen dhe blerje përmes aplikacionit.



## Jam i vetëdijshëm që fëmija im mund të luajë në platforma të video lojërave në internet të cilat i mundësojnë të:

- Bisedojë me lojtarë/e të tjer-ë/a që ai/ajo nuk i njeh domosdoshmërisht
- T'u dërgojë mesazhe, fotografi e video

## E mësoj atë të mbrojtë veten:

- Në internet, është e rëndësishme të mbron informacionet e tij personale, privatësinë dhe intimitetin e tij.
- Është e nevojshme të përdorni fjalëkalime të ndryshme, t'i ndryshoni rregullisht dhe t'i mbani të fshehta.
- Publikimet e tij (foto, video, mesazhe etj.) mbeten përgjithmonë në internet dhe krijojnë për të një imazh (përshtypjet që të tjerët krijojnë për të).
- Të dhënat personale që ai/ajo poston mund të përdoren kundër tij/saj.
- Njerëzit që ai/ajo takon mund të gënjejnë. Nuk dihet asnjëherë se kush fshihet pas ekranit.
- Disa përmbajtje nuk janë për moshën e tij/saj dhe mund ta trondisin atë.



## Unë i shpjegoj atij/asaj se platformat e video lojërave në internet nuk janë hapësira pa ligj:

- Sipas ligjit, është e ndaluar:
  - Të fyejë ose kërcënojë një person në këto platforma;
  - Të dëmtojë reputacionin e dikujt;
  - Të publikojë një foto ose video pa pëlqimin e personit që shfaqet në të.
- Nëse fëmija im gjendet në një nga këto situata, ai/ajo ka të drejtë të bëjë ankesë.
- Në Zvicër, sipas ligjit, fëmija im është përgjegjës për veprimet e tij që nga mosha 10 vjeç.

## Unë vendos rregulla:

- Kufizoj kohën para ekranit në mënyrë që fëmija im të mund:
  - Të ushtrohet fizikisht;
  - Të flejë mjaftueshëm;
  - Të bëjë aktivitete të larmishme.
- I diskutoj rregullat me të.
- I propozoj t'i shkruajë rregullat dhe t'i afishojë ato.
- Unë i ndryshoj rregullat në varësi të moshës së fëmijës tim.
- I flas për pasojat e shkeljes së rregullave.



## Për të më ndihmuar që të ruaj rregullat:

- Unë vendos rregulla dhe kufizime për të mirën e fëmijës tim.
- E mësoj atë të kontrollojë emocionet e tij, kur ai/ajo luan dhe kur ai/ajo ndalon lojën.
- Unë instaloj kontrollin prindëror.
- Përdor një kohëmatës për të kufizuar kohëzgjatjen e lojës.
- Unë reduktoj kohën time para ekranit për t'i dhënë një shembull.
- Gjej kohë për të parë fëmijën tim duke luajtur, e përgëzoj dhe e inkurajoj.
- Unë luaj një video lojë me të.



## Kam arsye të shqetësohem nëse:

- Fëmija im kalon gjithnjë e më shumë kohë duke luajtur dhe shmang aktivitetet e tjera.
- Ai/ajo zemërohet rregullisht nëse nuk mund të luajë ose duhet të ndalojë lojën.
- Ai/ajo ka mungesa të shumta në shkollë.
- Rezultatet e tij shkollore janë në rënie.
- Ai/ajo ka pagjumësi.
- Ai/ajo bëhet agresiv/e.
- Ai/ajo izolohet dhe mbyllet në vetvete.



# Fëmija im përdor internetin dhe rrjetet sociale



## E di që interneti dhe rrjetet sociale i krijojnë atij/asaj mundësinë të:

- Qëndrojnë në kontakt me miqtë e tij/saj
- Marrë pjesë në diskutime që janë të rëndësishme për të
- Jetë i/e vlerësuar dhe i/e njohur nga të tjerët
- Zhvillojë shpirtin krijues dhe imagjinatën e tij
- Bëjë kërkime
- Mësojë dhe zbulojë gjëra të reja

## Unë e mësoj atë të mbrohet:

- Në Internet, është e rëndësishme të mbrojnë informacionet e tij personale, jetën e tij private dhe intimitetin e tij.
- Është e rëndësishme të përdoren fjalëkalime të ndryshme, të ndryshohen rregullisht dhe të mbahen të fshehta.
- Publikimet e tij/saj (foto, video, mesazhe etj.) mbeten përgjithmonë në Internet dhe i krijojnë një imazh (përshtypjen që të tjerët krijojnë për të).
- Të dhënat personale që ai/ajo poston mund të përdoren kundër tij/saj.
- Njerëzit që ai/ajo takon në Internet mund ta gënjejnë. Asnjëherë nuk e dimë se kush mund të fshihet pas ekranit.
- Disa përmbajtje në Internet nuk janë për moshën e tij/saj dhe mund ta trondisin atë.
- Nëse një foto e tij/saj është publikuar pa pëlqimin e tij/saj, ai/ajo ka të drejtë të kërkojë fshirjen e saj.



## I shpjegoj se Interneti nuk është një hapësirë pa ligj:

- Sipas ligjit, është e ndaluar:
  - Të fyesh ose të kërcënosh një person në Internet;
  - Të dëmtosh reputacionin e tij/saj;
  - Të publikosh një foto ose video pa pëlqimin e personit që shfaqet në të.
- Nëse fëmija im gjendet në një nga këto situata, ai/ajo ka të drejtë të bëjë ankesë.
- Në Zvicër, sipas ligjit, fëmija im është përgjegjës për veprimet e tij që nga mosha 10 vjeç.

## Unë e shoqëroj:

- Unë e ndihmoj fëmijën tim të vendosë përmasat e privatësisë në rrjetet sociale.
- Unë informohem për aplikacionet që ai/ajo shkarkon.
- Unë jam aty për t'iu përgjigjur nëse ai/ajo ka pyetje ose përballet me një situatë të vështirë.
- Unë e reduktoj kohën time para ekranit për të dhënë shembull para tij/saj.





## Unë vendos rregulla:


- Unë kufizoj kohën para ekranit në mënyrë që fëmija im të mund:
  - Të ushtrohet fizikisht;
  - Të flejë mjaftueshëm;
  - Të bëjë aktivitete të larmishme.
- Unë i diskutoj rregullat me të.
- Unë i propozoj t'i shkruajë rregullat dhe t'i afishojë ato.
- Unë i përshtas rregullat sipas moshës së fëmijës tim.
- Unë i flas për pasojat e mos respektimit të rregullave.

## Unë kam të drejtë të shqetësohem nëse:

- Fëmija im kalon gjithnjë e më shumë kohë në Internet dhe shmang aktivitetet e tjera.
- Ai/ajo kalon më pak kohë me shokët/shoqet e tij/saj.
- Ai/ajo ka mungesa të shumta në shkollë.
- Rezultatet e tij/saj shkollore janë në rënie.
- Ai/ajo ka pagjumësi.
- Ai/ajo bëhet agresiv/e.
- Ai/ajo izolohet dhe mbyllet në vetvete.



# **Ekspozimi ndaj përmbajtjeve të dhunshme ose pornografike**



**Kur fëmija im përdor një ekran, ai/ajo mund të hasë një përmbajtje të dhunshme ose pornografike.**

## **Kjo lloj përmbajtjeje mund të shfaqet:**

- Në një mesazh (me email, me mesazh, etj.)
- Gjatë kërkimeve në Internet
- Në rrjetet sociale
- Kur ai/ajo luan një video lojë ose shikon një seri apo film që nuk është i përshtatshëm për moshën e tij/saj

## **Unë e mësoj atë të mbrohet:**

- Është e rëndësishme të mos klikojë në një lidhje që një i panjohur i dërgon me email, me mesazhe ose në rrjetet sociale.
- Gjatë kërkimeve në Internet, mund të shfaqen përmbajtje të papërshtatshme edhe pse kërkimi nuk ka lidhje me një subjekt të dhunshëm apo pornografik.
- Në rrjetet sociale, një përmbajtje tronditëse mund të shfaqet para tij gjatë prurjeve të informacioneve të fundit.

## **Unë e shoqëroj:**

- Interesohem për personalitetet (ndikues-it/et) dhe dhe përmbajtjet që ndjek fëmija im në Internet dhe në rrjetet sociale.
- Ja bëj të qartë se ai/ajo mund të më kontaktojë në çdo moment edhe nëse është i turbulluar nga përmbajtja që ai/ajo ka parë.
- E këshilloj atë të përcaktojë të rriturit e besueshëm me të cilët ai/ajo mund të flasë (mësues-it/et, infermier-ët/et e shkollës etj.).
- Në varësi të moshës së tij/saj, unë instaloj kontrollin prindëror.



## Unë i shpjegoj atij pse ai/ajo nuk duhet ta shpërndajë këtë lloj përmbajtjeje:

- Një përmbajtje e dhunshme ose pornografike mund të trondisë të tjerët.
- Kjo lloj përmbajtjeje mund të jetë e paligjshme. Mbajtja dhe shpërndarja e tij mund të dënohet me ligj.
- Në Zvicër, fëmija im, sipas ligjit, është përgjegjës për veprimet e tij që nga mosha 10 vjeç.

## Kam arsye të shqetësohem nëse:

- Fëmija im kalon gjithnjë e më shumë kohë në Internet ose në të kundërtën shmang hyrjen në Internet.
- Ai/ajo ka mungesa të shumta në shkollë.
- Rezultatet e tij shkollore janë në rënie.
- Ai/ajo ka dhimbje koke ose barku.
- Ai/ajo ka pagjumësi.
- Ai/ajo bëhet agresiv/e.
- Ai/ajo izolohet dhe mbyllet në vetvete.



## Fëmija im është i ekspozuar ndaj përmbajtjeve të dhunshme ose pornografike. Çfarë mund të bëj?

- Unë e dëgjoj dhe e inkurajoj të flasë.
- Unë e ndihmoj të kuptojë atë që ka parë dhe i jap siguri:
  - Unë i krijoj mundësinë të shprehë emocionet e tij/saj. Fëmija im mund të ndiejë frikë, ankth, neveri, siklet etj.
  - Unë nuk e gjykoj atë.
  - Unë i jap shpjegime në përshtatje me moshën dhe nivelin e tij/saj gjuhësor. Sa më i ri/e re të jetë aq më thjesht duhet të zgjidhen fjalët.
  - Unë mbetem i përgjithshëm në shpjegimet e mia dhe i jap mundësinë fëmijës tim të bëjë pyetje, që e ndihmojnë të identifikojë se çfarë e intereson dhe e shqetëson atë.

### Çfarë thotë ligji zviceran?

- Përfaqësimi i dhunës, neni 135, paragrafi 1 dhe 2, CP
- Pornografia, neni 197, paragrafi 1, CP



# Ngacmimi dhe kërcënimi kibernetik mes nxënësve



**Ngacmimi mes nxënësve mund të ndodhë çdo ditë, kur fëmija im është duke ndërvepruar me të rinj të tjerë, për shembull në shkollë, jashtë shkollës ose rrugës për në shkollë. Bëhet fjalë për sulme të përsëritura, si tallje, fyerje, poshtërime, shtyrje, goditje, lënie mënjanë, etj. Ngacmimi është një fenomen grupi që mund të zgjasë. Viktima është e izoluar dhe e paaftë që të mbrohet.**

## **Ngacmimi kibernetik**

Përdorimi i mjeteve dixhitale çon në shpërndarjen më të gjerë e të shpejtë, pa limit vendi ose kohe (24orë/24orë dhe 7ditë/7), gjë që përforcon fenomenin e ngacmimit.

Ngacmimi dhe kërcënimi kibernetik mund të kenë pasoja të rënda në shëndetin fizik dhe psiqik të fëmijës.

## **Unë e mbështes fëmijën tim:**

- Unë i tregoj qartë fëmijës tim se ai/ajo mund të më flasë në çdo kohë.
- Unë e këshilloj atë të identifikojë të rriturit e besueshëm në shkollë dhe në rrethin e tij/saj të cilëve mund t'u flasë, nëse ka një problem (mësues·ve·eve, infermier·ëve·eve shkollorë·e, etj.).
- Unë i shpjegoj atij/asaj se ai/ajo nuk ka përgjegjësi për talljet që mund të përjetojë.
- Unë i shpreh mbështetjen time. Unë jam aty për ta mbrojtur atë nëse ai/ajo merr kërcënime për hakmarrje.



## Unë kam arsye të shqetësohem nëse:

- Fëmija im arrin gjithmonë me vonesë në shkollë. Ai/ajo mund të përpiqet të shmangë shokët e klasës në oborr ose në korridore.
- Ai/ajo nuk dëshiron të marrë pjesë në aktivitetet shkollore ose jashtëshkollore.
- Ai/ajo ka mungesa të shumta në shkollë.
- Rezultatet e tij shkollore janë në rënie.
- Ai/ajo ka shpesh dhimbje koke ose barku.
- Ai/ajo ka pagjumësi.
- Ai/ajo ka çrregullime me të ushqyerit.
- Ai/ajo bëhet agresiv-e.
- Ai/ajo izolohet dhe mbyllet në vetvete.
- Ai/ajo tregon vetëbesim të ulët.





## Fëmija im është objekt i kërcënimit kibernetik. Çfarë mund të bëj?

- Unë i kërkoj të më përshkruajë situatën në të cilën ai/ajo ndodhet.
- Unë e dëgjoj pa e gjykuar.
- Unë i kërkoj nëse mund të konsultoj mesazhet, fotot apo videot që qarkullojnë në internet për të.
- Unë e njoftoj mësues-in/en e tij/saj dhe drejtorinë e shkollës që ta marrë situatën në dorë e t'i japë sa më parë fund asaj.
- E di që në varësi të fakteve, ligji mund ta mbrojë fëmijën tim.
- Me pëlqimin e fëmijës tim, unë mbledh dhe ruaj prova (foto, video ose shkrepte të mesazheve në ekran).
- Mund të kontaktoj me telefon stacionin më të afërt të policisë për të raportuar rastin.
- Sipas këshillave të policisë,
  - Me prova shkoj në komisariat me ose pa fëmijën tim.
  - Bëj ankesë.
  - Unë sinjalizoj përmbajtjen dhe bllokoi llogarinë e kërcënues-ve/eve.



## Për të më ndihmuar që të mbështes fëmijën tim:

- E di që ai/ajo është viktimë. Fajësimi i tij/saj nuk do të zgjidhë situatën dhe nuk do krijojë besim te ai/ajo për të më treguar dhe dhënë sa më shumë informacione.
- Jam i durueshëm/e durueshme. Fëmija im ka nevojë për kohë për të treguar se çfarë i ndodh.
- I propozoj mbështetje psikologjike fëmijës tim.

## Nëse fëmija im është dëshmitar i ngacmimit e kërcënimit kibernetik:

- Unë i shpjegoj atij se roli i tij/saj është vendimtar dhe mund t'u lejojë të rriturve të identifikojnë situatën dhe të marrin përgjegjësi për të.
  - E ftoj të më flasë ose t'i besohet një të rrituri në shkollën e tij, te i cili ka besim.
  - I kërkoj që të mos marrë pjesë në tallje.
  - Unë e inkurajoj që të shprehë mbështetjen e tij për viktimën.
  - Nëse fëmija im ka frikë nga hakmarrja, nëse e shpreh mospajtimin e tij/saj me situatën, e këshilloj që të flasë me miqtë e tij/saj dhe të shohë nëse ata mund të veprojnë së bashku.



## Çfarë thotë ligji zviceran?

Këto nene të ligjit mund të citohen veçanërisht gjatë paraqitjes së një ankese:

- Mbrojtja e personalitetit / kundër sulmeve, neni 28, paragrafi 1, CC
- Poshtërimi, neni 173, paragrafi 1, CP
- Shpifje, neni 174, paragrafi 1 dhe 2, CP
- Fyerje, neni 177, paragrafi 1, CP
- Kërcënimet, neni 180, paragrafi 1, CP



# Takimet e këqija në linjë (*grooming*)



**Si prind, duhet të kem parasysh se fëmija im mund të takojë njerëz të panjohur në internet. Një nga rreziqet me të cilat ai/ajo mund të përballlet është *grooming*.**

## **Çfarë është *grooming*?**

Hyrja në kontakt dhe kërkimi i vendosjes së një marrëdhënieje me fëmijë dhe adoleshent-ë-e që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale 16 vjeç me synim për të arritur një kënaqësi seksuale ose për të pasur marrëdhënie me karakter seksual.

## **Si ndodh takimi?**

Në shumicën e rasteve, një individ përpiqet fillimisht të kontaktojë me një fëmijë nëpërmjet shërbimit në linjë. Ai mund të fillojë për shembull me një diskutim në një rrjet social, një forum ose një platformë video-lojërash në internet, duke ruajtur identitetin e tij ose duke pretenduar se është një person në një moshë me fëmijën.



## Ndërtimi i besimit:

Personi mund të përpiqet të krijojë një marrëdhënie besimi me fëmijën.

Ai/ajo mundet për shembull:

- Të bëjë pyetje rreth temave që i interesojnë fëmijës
- Të zhvillojë marrëdhënien rreth interesave të përbashkëta
- Të pyesë gradualisht fëmijën se si ai/ajo ndihet, përpiqet të dijë nëse ai/ajo ka vështirësi në miqësitë e tij ose në marrëdhëniet e tij/saj me prindërit
- Nëse fëmija është në vështirësi dhe e pranon se ndjehet keq
- Të vendoset në pozicionin e një njeriu të besueshëm

Pasi të jetë krijuar besimi dhe të vendoset një lidhje miqësore apo edhe romantike, personi mund të kërkojë të trajtojë pyetje më intime.

## Shembuj pyetjesh:

- A të pëlqen të flesh lakuriq?
- A ke puthur ndonjëherë?
- A vesh sutjena ose tanga?
- A ke qime?
- A janë duke t'u rritur gjinjtë?
- A e ke matur ndonjëherë penisin tënd?



## Kur fëmija do të ndjehet i sigurtë dhe e ul vigjilencën e tij/saj, personi mund të përpigjet të trajtojë pyetje që shkojnë më larg:

- I kërkon fëmijës t'i çojë foto intime
- I dërgon atij/asaj foto të organeve të tij gjenitale
- I propozon një takim në linjë (për shembull, një seancë video)
- I propozon një takim të drejtpërdrejtë

## Kam arsye të shqetësohem nëse:

- Fëmija im kalon gjithnjë e më shumë kohë në Internet dhe shmang aktivitetet e tjera.
- Ai/ajo kalon më pak kohë me shokët/shoqet e tij/saj.
- Ai/ajo flet shpesh me një person që nuk e njoh.
- Ai/ajo e ndërron shpejt imazhin në ekranin e tij/saj kur jam pranë tij/saj.
- Ai/ajo merr nëpërmjet postës letra, pako ose telefonata nga njerëz që nuk i njoh.
- Ai/ajo ka para që nuk ia kam dhënë unë ose rroba e objekte të tjera që nuk ia kam blerë unë.
- Ai/ajo ka mungesa të shumta në shkollë.
- Rezultatet e tij/saj shkollore janë në rënie.
- Ai/ajo bëhet agresiv-e.
- Ai/ajo mbyllet në vetvete.
- Ai/ajo tregon vetëbesim të ulët.



## Unë mendoj se fëmija im është viktimë e grooming. Çfarë mund të bëj?

- Unë i flas fëmijës tim për frikën dhe shqetësimet e mia.
- Unë i kërkoj më shumë informacione për marrëdhëniet që ka.
- Unë e dëgjoj pa e gjykuar.
- I kërkoj nëse mund të konsultoj shkëmbimet me këtë person.
- E di që në varësi të fakteve, ligji mund të mbrojë fëmijën tim.
- Me pëlqimin e tij, mbledh dhe ruaj prova (foto, ose shkrepte të ekranit me pamjen e profilit të individit dhe fëmijës tim dhe mesazhet e shkëmbyera).
- Mund të kontaktoj me telefon stacionin më të afërt të policisë për të raportuar rastin.
- Sipas këshillave të policisë,
  - Me prova shkoj në komisariat me ose pa fëmijën tim.
  - Bëj ankesë.
  - Sinjalizoj dhe bllokoj llogarinë e personit.





## Për të më ndihmuar të mbështes fëmijën tim:

- Unë e di që ai/ajo është viktimë. Fajësimi i tij/saj nuk do të zgjidhë situatën dhe nuk do krijojë besim te ai/ajo për të më treguar dhe dhënë sa më shumë informacione.
- Jam i vetëdijshëm që mund të jetë e vështirë për fëmijën tim të pranojë përfundimin e një marrëdhënieje miqësore apo romantike, të cilën ai/ajo e ka vlerësuar si të vërtetë dhe të sinqertë.
- Gjej kohë për t'i shpjeguar fëmijës tim që,
  - Ajo që personi po bën është ilegale dhe për këtë arsye ne ankohe mi në polici;
  - Ligji ekziston për ta mbrojtur atë.
- I propozoj mbështetje psikologjike fëmijës tim.



## Çfarë thotë ligji zviceran?

Këto nene të ligjit mund të citohen veçanërisht gjatë paraqitjes së ankesës:

- Akte të natyrës seksuale me fëmijët, neni 187 CP
- Pornografia, neni 197, paragrafi 1, 3, 4 ose 5 CP
- Kërcënimet, neni 180, paragrafi 1 CP
- Detyrimi, neni 181 CP
- Detyrimi me forcë dhe shantazhi, neni 156 CP





## Kontakt

**Action Innocence**

Rue Viollier 4

1207 Gjenevë, Zvicër

Tel. +41 22 735 50 02

[contact@actioninnocence.org](mailto:contact@actioninnocence.org)

[www.actioninnocence.org](http://www.actioninnocence.org)

